REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 688/20
Date/Datum. 16.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 688/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik: "Vëllezërit Hoti" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar OE N.P.T. "Bakalli Metal", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh në Pejë", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Pejë, më datë: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik "Vëllezërit Hoti" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh në Pejë", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Pejë.

II.ANULOHET, njoftimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh në Pejë", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Pejë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik ankues "Vëllezërit Hoti" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues "Vëllezërit Hoti" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.09.2020 me nr. 688/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh në Pejë", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 60, 66 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendojnë qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, si dhe pas sqarimeve te kërkuara nuk e ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, konkretisht dëshminë që ka përfunduar projekte te ngjashme në tre vitet e fundit, dhe OE pretendon se ka mospërputhje të mëdha në mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (punë me konstruksione metalike,) në vlerë prej 200.000.00 Euro në 3 (tre) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet t'i ketë së paku 50% të shumës së kërkuar

punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve. Kontratat duhet të kenë procesverbalet si dhe Referencat, në të kundërtën nuk do të merren parasysh nga AK".

Pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të plotësuar sipas Aneksit 6 të dosjes së tenderit ashtu siç është kërkuar, dhe ka paraqitur kontratat dhe referencat si dëshmi që janë konform DT-së. Ndërsa sa i përket mospërputhjes në mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara, eksperti shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar një gjë e tillë. Andaj duke pas parasysh kërkesat e DT-së dhe dëshmitë e ofruar nga i rekomanduari për kontratë eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

GOE ankues pretendojnë qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka përmbushur kriteret siç kërkohen në FDT, kërkesa me numër 4 lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve, nuk ka ofruar dëshmi që posedon ose ka marrëveshje mbi qeren për makinerinë për zallim të konstruksionin metalik.

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë është kërkuar: "Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve..... Makineri për Zallim të konstruksionin Metalik Minimum 1 copë". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet t'i ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore , apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid - Kopja e librezave të pajisjeve. Njoftim - Komisioni vlerësues do ta bëj edhe verifikimin e pajisjeve në vend punishte të OE të cilët marinë pjesë në këtë Aktivitet Prokurimi".

Pas analizës së dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues vlerëson që OE ka ofruar një listë të makinerisë në të cilën gjendet edhe makineria për zallim të konstruksioneve metalike (me të dhënat T 14606,prodhues SAPI GMBH), mirëpo OE për pajisjen e kërkuar nuk ka ofruar dëshminë siç është kërkuar në Dosje të Tenderit, rrjedhimisht ky pretendim ankimorë është i bazuar për faktin se i mungon dëshmia e kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare dëshmi siç kërkohen në paramasë dhe parallogaritë, A-teste dhe katalogun për reflektorëve për ndriçim, duke mos ofruar karakteristika siç kërkohen.

Pas analizës së dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungon A-teste dhe katalogu për reflektorët dhe AK është

dashur të kërkoj sqarime andaj ky pretendim është i bazuar dhe eksperti rekomandon që gjatë rivlerësimit konform dispozitave te LPP-së AK mund të kërkoj sqarime.

Sqarim:

Po ashtu ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 te Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigjeje vetëm në pretendimet qe kanë qenë të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues rekomandon Panelin Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Grupi i Operatorëve Ekonomik më datë: 05.10.20, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar:

Lidhur me raportin e ekspertit nr. 688/20 të datës 05.10.2020, ne pajtohemi pjesërisht dhe kërkojmë mbajtje të senacës. Në lidhur me sqarimin e ofruar në fund nga ana e ekspertit , që citon se i është përgjigjur vetëm pretendimeve që kanë qenë të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim, duke mos ju përgjigjur pretendimeve të Ankesës, mendoj që nuk është ekspertizë e drejtë, ngase ne vetëm pas Parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim, kemi marrë dëshmitë e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe që faktet për mospërputhje të vlerave të kontratave dhe pagesave në bankë i kemi parashtruar në ankesë, deri në kthimin e përgjigjes të Kërkesës për rishqyrtim nga ana e Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk na ka ofruar dëshminë e transaksioneve bankare, rrjedhimisht ne nuk kemi pasur mundësi pa pasur informacione t'i analizojmë Kontratat me fletëpagesat bankare.

Kërkoj që pretendimet e ankesës së dorëzuar të analizohen në detaje.

Autoriteti Kontraktues më datë: 08.10.20, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar:

Ju njoftojmë se ne si AK pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit:

Tek pretendimi i parë AK pajtohet me mendimin e ekspertit, se pretendimi i OE ankues është i pa bazë. Tek pretendimi i dytë, AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit pasi që në listën e pajisjeve të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë gjendet edhe makina për zallim të konstrukcioneve metalike (me të dhënat T-14606 e prodhuesit Sapi GMBH). Komisioni vlerësues duke pasur njohuri se OE i rekomanduar për kontratë e posedon këtë makinë nuk është lëshuar në verifikim të detajeve, pasi që

AK -se i lejohet të vepronte sipas nenit 72 të LPP-së. Pasi e kemi marr këtë informatë AK-së duke u bazuar në njoftimin e cekur në DT, ka shkuar në vend punishte për verifikim dhe ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë e posedon makinën e lartcekur që nga viti 2014 të cilën e ka ofruar në listën e pajisjeve, ndërkohë ai e ka dorëzuar kontratën e shitblerjes të dt: 09.10.2014 po me të njëjtat të dhëna dhe të njëjtit prodhues të paraqitur në listën e mjeteve.

Pretendimi i tretë - Edhe te ky pretendim AK i ka vërejtjet e veta dhe nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit. Këtu eksperti sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungojnë A-testet dhe katalogu për reflektorë dhe AK është dashur të kërkojë sqarime. Kjo kërkesë ka qenë e specifikuar në specifikim teknik (paramasë) e jo në kërkesat e vendosura nga AK siç janë në DT dhe NjK. Këtë gjë OE i rekomanduar për kontratë e ka mbuluar me deklaratën mbi specifikimin teknik të detyrueshëm të dorëzuar në ofertën e tij, ku i ka pranuar të gjitha specifikimet e parapara në paramasë, dhe në ditën e vizitës në vend punishte i ka dorëzuar A-testet dhe katalogun e kërkuar. Edhe neni 59.4 i LPP-se lejon devijime të vogla që nuk mund te shkaktojnë ndryshime materiale. Të gjitha këto dokumente po ia bashkëngjisim kësaj shkrese. Te ky AP , Autoriteti Kontraktues e ka pasur në konsideratë edhe ruajtjen dhe kursimin e parasë publike që është edhe moto kryesore e LPP-së.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që t'i merr në konsideratë të gjitha këto sqarime dhe t'a vërtetoj Vendimin e AK-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

OE ankues pretendojnë qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, si dhe pas sqarimeve te kërkuara nuk e ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, konkretisht dëshminë që ka përfunduar projekte te ngjashme në tre vitet e fundit, dhe OE pretendon se

ka mospërputhje të mëdha në mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (punë me konstruksione metalike) në vlerë prej 200.000.00 Euro në 3 (tre) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet t'i ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve. Kontratat duhet të kenë procesverbalet si dhe Referencat, në të kundërtën nuk do të merren parasysh nga AK". OE të rekomanduar për kontratë, ka prezantuar një listë të plotësuar sipas Aneksit 6 të dosjes së tenderit ashtu siç është kërkuar, dhe ka paraqitur kontratat dhe referencat si dëshmi që janë konform DT-së. Ndërsa sa i përket mospërputhjes në mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara, paneli shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar një gjë e tillë. Andaj, duke pas parasysh kërkesat e DT-së dhe dëshmitë e ofruar nga i rekomanduari për kontratë paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka përmbushur kriteret siç kërkohen në FDT, kërkesa me numër 4 lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve, nuk ka ofruar dëshmi që posedon ose ka marrëveshje mbi qira për makinerinë për zallim të konstruksionin metalik.

Paneli shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë është kërkuar: "Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve..... Makineri për Zallim të konstruksionin Metalik Minimum 1 copë". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet t'i ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore, apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid - Kopja e librezave të pajisjeve. Njoftim - Komisioni vlerësues do ta bëj edhe verifikimin e pajisjeve në vend punishte të OE të cilët marinë pjesë në këtë Aktivitet Prokurimi".

OE të rekomanduar për kontratë, ka ofruar një listë të makinerisë në të cilën gjendet edhe makineria për zallim të konstruksioneve metalike (me të dhënat T 14606, prodhues SAPI GMBH), mirëpo OE për pajisjen e kërkuar nuk ka ofruar dëshminë siç është kërkuar në Dosje të Tenderit, andaj duke pasur parasysh këtë paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë

konform nenit 72 të LPP-së nga OE i rekomanduar për paisjet motorike në mënyrë që të dëshmohet se a i mungon dëshmia e kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë apo jo.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare dëshmi siç kërkohen në paramasë dhe parallogaritë, A-teste dhe katalogun për reflektorëve për ndriçim, duke mos ofruar karakteristika siç kërkohen.

Paneli shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungon A-teste dhe katalogu për reflektorët, ndërkaq AK në përgjigjen e tyre me shkrim kanë deklaruar se "OE i rekomanduar për kontratë e ka mbuluar me deklaratën mbi specifikimin teknik të detyrueshëm të dorëzuar në ofertën e tij, ku i ka pranuar të gjitha specifikimet e parapara në paramasë, dhe në ditën e vizitës në vend punishte i ka dorëzuar A-testet dhe katalogun e kërkuar". Paneli shqyrtues duke pasur parasysh se në ofertën e OE të rekomanduar mungojnë A-testet dhe katalogu për reflektoret, andaj AK obligohet të kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar konform nenit 72 të LPP-së dhe të verifikoj se OE në fjalë plotëson kërkesën e vendosur në specifikime teknikë (paramasë).

Paneli shqyrtues sqaron se ka dhënë përgjigje vetëm në pretendimet ankimore të cilat kanë qenë të parapara në kërkesën për rishqyrtim konform nenit 9 paragrafi 2 te Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së më saktësisht nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së sa i përket pajisjet motorike se a janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid - Kopja e librezave të pajisjeve si dhe të verifikoj se OE i rekomanduar a e plotëson specifikimin teknik për A-testet dhe katalogun për reflektoret.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së si dhe të marr parasysh nenin 60 të LPP-së. Po ashtu, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna Pejë

1x1 Grupi i OE – "Vëllezërit Hoti" SH.P.K & "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.